



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale  
Komisioneri

Nr. 162 / Prot.  
5

Tiranë, më 11/3/2014

**REKOMANDIM**

Nr 21, datë 11/03/2014

Mbështetur në ligjin nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar, Vendimet e Kuvendit të Shqipërisë nr 211, datë 11.09.2008 "Për zgjedhjen e Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" dhe nr. 225, datë 13.11.2008 "Për miratimin e strukturës organike dhe kategorizimit të pozicioneve të punës të zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", pas shqyrtimit të relacionit të Drejtorisë së Hetim-Inspektimit në ngarkim të kontrolluesit "Star Broker" sh.a, Tiranë.

**KONSTATOVA**

Në zbatim të urdhrin nr. 26 datë 05.02.2014 të Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, është kryer kontrolli administrativ pranë kontrolluesit "Star Broker" sh.a me objekt: **Zbatimi nga ana e kontrolluesit "Star Broker" sh.a, i ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave personale" i ndryshuar, si dhe aktet e miratuara nga Komisioneri, gjatë kryerjes së aktivitetit të tij në fushën e sigurimit të detyrueshëm në sektorin e transportit.**

Kontrolli administrativ ka filluar kryesisht nga zyra e Komisionerit dhe kontrolluesi është njoftuar paraprakisht për kryerjen e kontrollit. "Star Broker" sh.a në kuptim të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" i ndryshuar, është kontrollues privat dhe si një shoqëri aksionere brokerimi kryen veprimtari private ndërmjetësimi në fushën e sigurimeve dhe risigurimeve. "Star Broker" sh.a mbledh, përpunon, ruan të dhëna personale të subjekteve të ndryshme të të dhënave, kryesisht individë/klientë, të punësuar, agjentë sigurimesh, aksionerë etj.

"Star Broker" sh.a, ka lidhur kontrata (brokerimi) për afrimin e shërbimeve me disa kontrollues (Sigal, Insig, Sigma, Intersig, Inter Albania, Albsig, Atlantik, Eurosig, Ansig) që veprojnë në fushën e sigurimeve dhe risigurimeve në Shqipëri, si dhe afron shërbime kontraktore për produkte të caktuara, për të gjitha Shoqëritë e Sigurimeve që veprojnë në fushën e sigurimeve dhe risigurimeve në Shqipëri.

Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale pasi shqyrtoi procesverbalin e kontrollit administrativ dhe provat e administruara vëren se:

1. Në "Kontratat e Brokerimit" të lidhura mes Shoqërive të Sigurimit dhe përpunuesit "STAR BROKER" sh.a me objekt: "dhënie e së drejtës për të kryer veprimtarinë e ndërmjetësimit për të lëshuar policat e sigurimit në emër dhe për llogari të Shoqërive të Sigurimit", nuk janë përcaktuar kushtet dhe kriteret e nenit 20 "Detyrimet e përpunuesit", të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar, si dhe Udhëzimi nr.19 datë 03.08.2012 "Mbi rregullimin e marrëdhënieve mes kontrolluesit

*dhe përpunuesit në rastet e delegimit të përpunimit të të dhënave dhe përdorimin e një kontrate tip në rastet e këtij delegimi”.*

Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale vlerëson se hartimi i një kontratë ku të merret përsipër garantimi për përdorimin e ligjshëm dhe të sigurisë të të dhënave është detyrë parësore e kontrolluesit. Ligjshmëria dhe siguria për përdorimin e të dhënave personale nga përpunuesi të parashikuara në ligjin nr. 9887 datë 10.3.2008 “*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*” i ndryshuar dhe akteve të Komisionerit duhet të jetë gjithmonë nën vëzhgimin dhe kontrollin nga ana e kontrolluesit.

2. “*STAR BROKER*”sh.a, nuk ka plotësuar detyrimin ligjor të parashikuar në nenin 21 “*Përgjegjësia për të njoftuar*” të ligjit nr. 9887 datë 10/03/2008 “*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*” i ndryshuar.

Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale vlerëson se përpunimi i të dhënave personale duhet të jetë një proces i bazuar në ligj dhe i drejtë, duke garantuar mbrojtjen maksimale të subjekteve të këtyre të dhënave. Për të realizuar njoftimin kontrolluesit duhet të kenë vëmendjen maksimale për të arritur në konkluzionin se përpunimi i të dhënave bëhet për një qëllim apo për disa qëllime. Në njoftim kontrolluesit deklarojnë një përshkrim të përgjithshëm të masave për sigurinë e të dhënave personale, nëse kontrolluesi ka hartuar, miratuar dhe zbaton rregulla konkrete të cilat bëjnë të mundur garancinë e sigurimit të të dhënave që përpunohen nga ana e tyre. Caktimi i një oficeri (*ose personi të ngarkuar*) sipas nenit 3/14 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “*Për mbrojtjen e të dhënave personale*” i ndryshuar, për mbrojtjen e të dhënave nga kontrolluesit, si dhe regjistrimi i tyre pranë KMDP shton besimin dhe transparencën e procesit të përpunimit të të dhënave personale nga këto kontrollues.

3. “*STAR BROKER*”sh.a nuk ka të hartuar (*apo të ketë të përfshira në rregulloren e tij*) rregulla të brendshme për mbledhjen, ruajtjen, përpunimin, sigurinë dhe konfidencialitetin e të dhënave personale, duke shkelur nenet 27 dhe 28 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “*Për mbrojtjen e të dhënave personale*” i ndryshuar.

Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale vlerëson se hartimi i rregulloreve është një pjesë e rëndësishme e masave të sigurisë që në tërësi zbaton kontrolluesi, prandaj është shumë e rëndësishme që ju si kontrollues të hartoni rregullore të veçantë për të përcaktuar rregulla për mbledhjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale. Në rregullore duhet të përcaktohen nivelet e përdoruesve, të drejtat e tyre, aksesit etj, si dhe rregulla lidhur me konfidencialitetin e të dhënave personale. Përmirësimi dhe plotësimi i rregullave është një siguri më shumë për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të subjekteve të të dhënave, gjatë përpunimit të të dhënave personale që kryeni ju si kontrollues.

Sa më sipër:

Në zbatim të neneve 29, 30 dhe 32 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*” i ndryshuar, si dhe nenet 107-109 të K. Pr. Administrative :

## **REKOMANDOJ**

1. Në zbatim të nenit 20 të ligjit nr. 9887 datë 10/03/2008 “*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*” i ndryshuar, si dhe Udhëzimi nr. 19 datë 03.08.2012 “*Mbi rregullimin e marrëdhënieve mes kontrolluesit dhe përpunuesit në rastet e delegimit të përpunimit të të dhënave dhe përdorimin e një kontrate tip në rastet e këtij delegimi*”;

- në “Kontratat e Brokerimit” të lidhura me Shoqëritë e Sigurimit, të përcaktohen kushte dhe kriteret të cilat garantojnë një përpunim të ligjshëm dhe të sigurt të të dhënave personale.

2. Në zbatim të nenit 21 të ligjit nr. 9887, datë 10.3.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar, të realizohet detyrimi për njoftim pranë Zyres së Komisionerit për përpunimin e të dhënave personale nga ju si kontrollues. Informacione të rëndësishme lidhur me njoftimin mund të gjeni në faqen zyrtare të Komisionerit [www.kmdp.al](http://www.kmdp.al), si dhe ofrojmë asistencën tonë.

3. Në zbatim të neneve 27 dhe 28 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” i ndryshuar, të hartohet rregullore e brendshme lidhur me mbledhjen, përpunimin, ruajtjen, sigurinë dhe konfidencialitetin e të dhënave personale. Rregulloren tip mund ta gjeni në faqen zyrtare të Komisionerit [www.kmdp.al](http://www.kmdp.al), si dhe ofrojmë asistencën tonë.

4. Kryerja e këtyre detyrimeve të rëndësishme të realizohet brenda një afati kohor prej 45 (dyzet e pesë) ditësh, nga momenti i marrjes dijëni të këtij Rekomandimi.

5. Për plotësimin e këtyre detyrimeve të njoftohet me shkrim pranë Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

6. Me kalimin e këtij afati në rast mospërbushje të këtyre detyrimeve, Komisioneri vepron sipas nenit 30, pika 2 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” i ndryshuar, sipas të cilit: “Komisioneri në rast shkeljesh serioze të përsëritura ose të qëllimshme të ligjit nga një kontrollues ose përpunues, veçanërisht në rastet e përsëritura të rekomandimeve të tij, vepron sipas nenit 39 të këtij ligji dhe e denoncon publikisht ose e raporton çështjen në Kuvend dhe në Këshillin e Ministrave”.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

**KOMISIONERI**

**FLORA ÇABEJ (POGAÇE)**

